

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME DY ORTAK
"JOANA-ENELA" SHPK

Sot me daten 23.05.2024 (dymijë e njëzet e katër), me ortakët themelues :

- **Z.Anton Noja** i biri i Gjon, shtetas Kosovar , i datëlindjes 27.06.1967, lindur në Kosovë, dhe banues në Durrës person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. Leternjoftimi/karte G736270090.
- **Znj. Kristinë Noja** e bija e Mark, shtetase Kosovare , e datëlindjes 08.04.1970, lindur në Kosovë, dhe banuese në Oberhofen,Zvicer person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit Pasaporte me Nr. X0R26K43.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me dy ortakë* " JOANA-ENELA" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " JOANA-ENELA" SHPK.


NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, "Lalez,Durres, Ndertese me Nr.Pasurie 169/139,Kod Unik 2375016181, Zona kadastrale 2375".

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e:

-Import, eksport, mbjellje të produkteve bujqësore, agjensi punësimi të huaj dhe vendas, kryerjen e procedurave ligjore për agjensinë e punësimi. Ushtrimin e të gjitha aktiviteteve që synojnë kultivimin e tokës, pylltarinë, mbarështimin e bagëtive, çdo aktivitet tjetër të lidhur me prodhimin, përpunimin, trajtimin, konservimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore, dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur dhe të ngjashëm me bujqësinë. Ushtrimi i aktiviteteve në agroturizëm. Tregtia me shumicë dhe pakicë e frutave dhe perimeve dhe produkteve ushqimore në përgjithësi, prodhimin dhe tregtimin e produkteve tipike ushqimore, përpunimi, prodhimi, paketimi, shitja dhe shpërndarja e produkteve ushqimore në përgjithësi, tregtia me pakicë e lëndëve



ushqyese dhe prodhimin e lëndëve të para ushqimore për tu shitur me pakicë, tregtia me pakicë dhe shumicë e lëndëve ushqimore. Tregtia me pakicë dhe shumicë e bimëve dhe luleve, farave, plehrave, vazove, artikuj dhe pajisje të kopshtarisë, artikujve dhe pajisjeve për bujqësi dhe blegtori dhe çdo gjë tjetër që lejon legjislacioni shqiptar. Projektme civile dhe industriale, punime të ndryshme ndërtimi si armim dhe disarmim armature, dërrase dhe metalike, përpunime hekur ndërtimi, mirëmbajtje godinash dhe montim të kapanoneve industriale. Kryerja e aktiviteteve tregtare në fushën e projektimit dhe ndërtimit të veprave të ndryshme civile, private dhe publike dhe rikonstruksioni i tyre. Projektim dhe ndërtim i rrjeteve hidraulike, elektrike, të ajrimit dhe kondicionimit, restaurim dhe mirëmbajtje vepra arti dhe monumente kulture. Ndërtim ujësjellësash, kanale vaditës dhe kullues, impiante vaditëse dhe vepra të tjera mbrojtëse. Ndërtim rrugësh dhe urash të të gjitha kategorive, diga, tunele, galeri, si dhe mirëmbajtjen e tyre përfshirë dhe sinajistikë rrugore. Prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit. Import dhe eksport i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit, hidraulike, elektrike, etj. Vlerësimi i pasurive të paluajtshme. Eksport, import, tregti, dhënie me qera të automjeteve të tonazheve të ndryshme.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "JOANA-ENELA" është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

- 1. Anton Noja zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**
- 2. Kristinë Noja zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**

NENI 5

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administratori i shoqërisë do të jetë **Z. Anton Noja** i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.



K. Noja

NENI 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8
NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9
LIKUJDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

ORTAKET THEMELUES TË SHOQËRISË
"JOANA-ENELA" SH.P.K

Anton Noja

Anton Noja



Kristinë Noja

Kristine Noja

